



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## ***BULETINI DITOR I FSSHM-së***

### ***PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE***

***20 Janar 2016***



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## Mbi 134 mijë persona me rrezik të lartë nga sëmundjet kardiovaskulare



Rrezik shumë të lartë të kenë sëmundje kardiovaskulare kanë 134.326 persona, ndërsa si pasojë e kësaj sëmundje pritet që 13.432 të kenë pasoja fatale në 10 vitet e fundit.

Kjo është konfirmuar te grupmoshat madhore prej moshës 24 deri në 65 vjet nga 381.878 të dhëna të përpunuara sipas kontrolleve parandaluese të zbatuara nga ana e mjekëve amë në vitin 2014 dhe 2015 për zbulim të hershëm dhe në kohë të sëmundjeve kardiovaskulare, sëmundjeve të veshkëve dhe diabetit melitus.

Nga 579.813 persona me diabet, 16.231 janë të sapozbuluar me gjendje paradiabetike dhe diabet, 3.007 janë me rrezik shumë të lartë, ndërsa 1.503 të siguar pritet që të fitojnë diabet. Rrezik i lartë nga sëmundjet nefrologjike është konfirmuar te 2.600 persona të siguar te të cilët pritet sëmundje në 10 vitet e ardhshme, ndërsa prej tyre 1.300 persona do të përfundojnë me dializë.



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



“Rezultatet nga qëllimet parandaluese të zbatuara te mjekët amë sot në konferencën për shtyp i prezantuan drejtorët e Fondit për Sigurim Shëndetësor të Maqedonisë, Sasho Stefanoski dhe Orhan Ramadani, të cilët theksuan se masat parandaluese janë zbatuar me qëllim të zbulimit të hershëm dhe në kohë të tre sëmundjeve më të shpeshta jo ngjitëse: sëmundjet kardiovaskulare, sëmundjet e veshkëve dhe diabeti melitus si dhe parandalimi sekondar i komplikimeve të mundshme prej tyre.

“Me qëllim të shëndetit të personave të siguruar, Fondi, së bashku me Odën e Mjekëve të Maqedonisë dhe Shoqatën e Mjekëve Privatë të Maqedonisë, shoqatat e mjekëve dhe faktorët e tjerë të sistemit shëndetësor, në marrëveshjet për vitin 2014 me institucionet shëndetësore private, vendosi tre qëllime si prioritet për parandalim. Periudha në të cilën u zbatuan kontrollet parandaluese të dakorduara te mjeku amë ishte parashikuar të zhvillohet dy vite – 2014 dhe 2015, që të ketë mjaft kohë të mund të përfshihen të gjithë siguruesit”, tha Ramadani.

Për këtë qëllim, në bashkëpunim me mjekët amë, potencoi, janë kryer kontrolle të siguruesve të moshës prej 24 deri në 65 vjet. Ishin targetuar 1,3 milionë sigurues prej të cilëve janë përpunuar të dhënat për 655.002 sigurues, që arrin 52 për qind e numrit të tërësishëm.

“Me realizimn e projektit të Qeverisë për parandalim të tre sëmundjeve jo ngjitëse kronike, kardiovaskulare, të veshkëve dhe diabetit, mundësojmë racionalizim dhe shfrytëzim të drejtë të mjeteve të Fondit, si dhe ngritje të kualitetit të mbrojtjes shëndetësore në shtet”, potencon Ramadani.

Sqaroi se mes siguruesve të kontrolluar me sëmundje kronike të cilët e kanë vizituar mjekun amë në vitin 2014/2015 dhe kanë marrë edhe këshillë në lidhje me gjendjen shëndetësore dhe broshura, 8,6 për qind (111.308 persona) janë me sëmundje kardiovaskulare, 0,42 për qind (5.534) janë me sëmundje neurologjike, ndërsa 6,9 për qind (89.349 persona) kanë diabet.

“Fondi ka realizuar edhe projekt plotësues “Fondi kujdeset për sëmundjet kronike”, me ç’rast ekipet e Fondit në telefon i përkujtojnë pacientët kronikë t’i përfundojnë kontrollet e rregullta dhe kontrollet dhe t’i respektojnë këshillat e mjekëve që të ndalohet keqësimi i gjendjes shëndetësore”, shtoi Ramadani.

Sipas rezultateve të kontrolleve parandaluese te mjekët amë, peshë të tepërt kanë 14,3 për qind (82.852 persona) nga personat e kontrolluar, që do të thotë se ato duhet ta zvogëlojnë peshën e trupit me zvogëlimin e ushqimit me nivel të lartë në ushqim me më pak yndyrëra dhe karbiohidrate, te 4,39 për qind (28.783 persona), në urinë u janë gjetur proteina, që është një nga shenjat e sëmundjeve nefrologjike, ndërsa te 3,86 (14.753 persona) me EKG është zbuluar rrahje jo e rregullt e zemrës.

Drejtori i FSSHM-së Sasho Stefanovski tha se parandalimi i tre sëmundjeve jo ngjitëse kronike: kardiovaskulare, sëmundje nefrologjike dhe diabeti është shumë e rëndësishme, për shkak të paraqitjes së



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)




shpeshtuar të këtyre sëmundjeve të cilat janë me përqindje të lartë të vdekshmërisë. Potenco i se Fondi në bashkëpunim me mjekët amë nga 1 janari filloi cikël të ri dyvjeçar për realizimin e qëllimeve parandaluese këtë vit dhe vitin e ardhshëm.

Përkushtimi ynë strategjik, potencon se është në bashkëpunim me të gjithë faktorët relevantë të sistemit shëndetësor ta promovojmë dhe stimulojmë parandalimin, sepse ky është një nga mekanizmat më të rëndësishëm për parandalim dhe zhvillim të sëmundjes.



## Sëmundjet kardiovaskulare, FSSh me masa të reja për parandalimin e tyre



**Mbi 135 mijë persona jetojnë me rrezik të lartë të sëmundjeve kardiovaskulare...**

Mbi 135 mijë persona jetojnë me rrezik të lartë të sëmundjeve kardiovaskulare, 13 mijë e 500 prej tyre madje rrezikojnë të kenë pasoja fatale nga këto sëmundje në dhjetë vitet e ardhshme.

Deri tek këto të dhëna Fondi Shëndetësor erdhi pas analizës së të dhënave nga kontrollat preventive të bëra nga mjekët amë në dy vitet e kaluara, përmes të cilave janë zbuluar në fazën e hershme sëmundjet kardiovaskulare, sëmundjet e veshkave dhe diabeti.

Drejtorët e Fondit Shëndetësor, Orhan Ramadani dhe Sasho Stevanovski, prezantuan sot të dhënat e viteve të shkuara dhe risitë në këtë drejtim për vitin 2016.



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: info@fzo.org.mk



## Maqedoni, katër raste të reja të infektuara me virusin HIV

**Shkup, 20 janar** – Listës së personave të infektuar nga virusi HIV në Maqedoni po u shtohen edhe katër raste të reja. Konkretisht, tek dy banorë të Strumicës dhe dy banorë të Shkupit, muajin e kaluar është diagnostifikuar infeksion me virusin HIV. Që të gjithë janë të gjinisë mashkullore, tre nga të cilët të moshës prej 20-29, ndërsa njëri më i moshuar se 40.

Me këto të dhëna, viti 2015 përfundoi me 31 raste të reja të HIV-Sidës. Përveç në Strumicë dhe Shkup, të infektuar ka edhe në Koçan, Shtip, Kavadar, Tetovë e Prilep.

Që nga viti 1987 kur u regjistrua i infektuari i parë, deri tani Instituti për Shëndet Publik, ka regjistruar gjithsej 274 raste. 80 prej tyre kanë vdekur.

## Zhurnal dhe Ambulanca COR-MEDICO ndajnë vauçerë për kontrolle falas të zemrës dhe barkut



**Shkup, 19 janar** – Agjencia e lajmeve Zhurnal së bashku me Ambulancën specialiste COR-MEDICO nga Shkupi, ka filluar një fushatë për ngritjen e vetëdijës tek qytetarët e Maqedonisë të cilët do të informohen për sëmundjet e ndryshme të zemrës dhe organeve tjera të trupit. Fushata e cila ka për qëllim që të sensibilizojë opinionin ka filluar këto ditë dhe do të vazhdojë gjatë muajve të ardhshëm.

Qëllimi i kësaj fushate është që qytetarët me kohë të parandalojnë sëmundjet e ndryshme, përfshirë këtu sëmundjet e zemrës dhe organeve të tjera të trupit. Për këtë qëllim Zhurnal së bashku me Ambulancën specialiste COR-MEDICO do të sigurojë më shumë se 10 vauçerë falas të cilët tju jepen lexuesve të Zhurnalit, të cilët mund të jenë pacient të mundshëm. Një vauçerë kapë vlerën prej mbi 50 euro, ndërsa lexuesit të cilët do të paraqiten në Agjencinë e lajmeve Zhurnal, të cilët do të jenë të moshës prej 40 deri 65 vjeç, do ti marrin vauçerat FALAS.

Çdo kush që do të merr një vauçer do të paraqitet në ambulance specialiste COR-MEDICO dhe falas do të bëjë eho të zemrës, eho të organeve të barkut dhe kontrolle të tjera. Të gjitha këto kontrolle falas parashihen në një vauçer. Poashtu Zhurnal i informon lexuesit se janë siguruar edhe vauçer për pensionistët.



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



Të gjithë të interesuarit të cilët janë të moshes prej 40 deri 65 vjeç, për të marrë vauçer duhet të shkruajnë në emailin e redaksisë: [info@zhurnal.mk](mailto:info@zhurnal.mk). Numri i vauçerëve është i kufizuar

## **Çdo i treti fëmijë në Maqedoni ka shpinë, këmbë shtrëmbuara ose është shkurtpamës**

Të dhënat e fundit nga sistemi mjekësorë flasin se cdo i treti fëmijë në Maqedoni ka problem me shpinën, me këmbët dhe me pamjen.

“Masat nga mjekët pediatër janë marë. Kujdesi ndaj shëndetit ka filluar që në moshë të re e për këtë pediatri duhet të realizojnë aktivitete në zbulimin tek fëmijët nga 3 deri në moshën 6 vjeçare që kanë deformitet në shpinë si dhe tek ato nga 6 deri në moshën 14 vjece. Nga 1 shtator të këtij viti këto masa fillojnë të udhëzohen në formë të shkruar me anë të sistemit elektronik”.

## **Zbulohen mbi 16 mijë të sëmurë të ri me diabet**

Rrezik shumë të lartë të kenë sëmundje kardiovaskulare kanë 134.326 persona, ndërsa si pasojë e kësaj sëmundje pritet që 13.432 të kenë pasoja fatale në 10 vitet e fundit.

Kjo është konfirmuar te grupmoshat madhore prej moshës 24 deri në 65 vjet nga 381.878 të dhëna të përpunuara sipas kontrolleve parandaluese të zbatuara nga ana e mjekëve amë në vitin 2014 dhe 2015 për zbulim të hershëm dhe në kohë të sëmundjeve kardiovaskulare, sëmundjeve të veshkëve dhe diabetit melitus.

Nga 579.813 persona me diabet, 16.231 janë të sapozbuluar me gjendje paradiabetike dhe diabet, 3.007 janë me rrezik shumë të lartë, ndërsa 1.503 të siguruar pritet që të fitojnë diabet. Rrezik i lartë nga sëmundjet nefrologjike është konfirmuar te 2.600 persona të siguruar te të cilët pritet sëmundje në 10 vitet e ardhshme, ndërsa prej tyre 1.300 persona do të përfundojnë me dializë.

Për këtë qëllim, në bashkëpunim me mjekët amë janë kryer kontrolle të siguriesve të moshës prej 24 deri në 65 vjet. Ishin targetuar 1,3 milionë siguries prej të cilëve janë përpunuar të dhënat për 655.002 siguries, që arrin 52 për qind e numrit të tërësishëm.

Mes siguriesve të kontrolluar me sëmundje kronike të cilët e kanë vizituar mjekun amë në vitin 2014/2015 dhe kanë marrë edhe këshillë në lidhje me gjendjen shëndetësore dhe broshura, 8,6 për qind (111.308 persona) janë me sëmundje kardiovaskulare, 0,42 për qind (5.534) janë me sëmundje neurologjike, ndërsa 6,9 për qind (89.349 persona) kanë diabet.

Sipas rezultateve të kontrolleve parandaluese te mjekët amë, peshë të tepërt kanë 14,3 për qind (82.852 persona) nga personat e kontrolluar, që do të thotë se ato duhet ta zvogëlojnë peshën e trupit me zvogëlimin e ushqimit me nivel të lartë në ushqim me më pak yndyrëra dhe karbohidrate, te 4,39 për qind (28.783



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



persona), në urinë u janë gjetur proteina, që është një nga shenjat e sëmundjeve nefrologjike, ndërsa te 3,86 (14.753 persona) me EKG është zbuluar rrahje jo e rregullt e zemrës.

## Lehtësohet puna e barnatoreve, nuk kërkohen farmacist të diplomuar për ndërrim deri në vitin 2018

Po shtyhet afati me të cilin në çdo ndërrim në barnatore mund të ketë të punësuar një farmacist, transmeton zhurnal.mk

Parlamenti i Republikës së Maqedonisë dje i solli ndryshimet e Ligjit për barna dhe mjete mjekësore, i propozuar nga grupi i deputetëve të VMRO-DPMNE-së dhe me to po mundësohet shtyrja e rregullit për farmacist të diplomuar në secilin ndërrim në barnatore deri me 1 janar të vitit 2018.

Tani barnatoret do të mund që të kanë të punësuar një farmacist të diplomuar, ndërsa ndërrimin mund ta realizojë edhe një teknik farmacist.

## Ndryshimi i kohës rrit tensionin tek qytetarët

Siç informoi EPSH Shtëpia e Shëndetit - Shkup, thirrjet janë nga qytetarë nga të gjithë qytetet e Maqedonisë. Paraqitjet janë më së shpeshti për simptome respiratore, shtypje e lartë e gjakur, temperaturë të rritur trupi, ftohje dhe kollitje të shkaktuara nga moti i ftohtë.

Në linjën telefonike 02/15 123 nga 15 shtatori i vitit 2014 kur filloi të punojë linja, deri më tani, ka pasur 72.062 thirrje.

-Linja është e hapur çdo ditë 24 orë me qëllim që të mundësohet konsultim i drejtëprëndrejtë mjekësor në momentin e paraqitjes së simptomave të ndryshme të çrregullimit të shëndetit. Për qytetarët janë në dispozicion gjithsej 25 mjekë, kumtoi Shtëpia e Shëndetit - Shkup.

Të gjithë atyre personave të cilët kanë kërkuar këshillë mjekësore në linjën telefonike "Alo doktor" u është dhënë ndihmë shëndetësore me këshillë dhe terapi adekuate simptomatike.



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## Gjermania kërkon motra medicinale edhe nga Maqedonia?



Sipërmarrjet gjermane e kanë të vështirë përshtatjen me tregun global të punës. Vërtet që ndalimi dikur i rreptë i kërkimit të punonjësve të huaj i përket së kaluarës, megjithatë migrimi në Gjermani i dëshiruar ndërkohë nga politika për punonjësit e kualifikuar ende nuk po manifestohet si dëshirohet. Problemi qendron në mungesën e kërkesës për fuqi punëtore të huaj nga punëdhënësit gjermanë. Një vështrim në degën ekonomike të përkujdesjes për të sëmurët e të moshuarit e vërteton këtë. Karakteristikë e kësaj dege është mungesa pjesërisht e madhe e punonjësve të specializuar. Gati dy të tretat e instituteve të përkujdesjes kanë vende pune bosh, mesatarisht në çdo sipërmarrje mungojnë 4,3 punonjës. Këtë e konstatoi tani në një studim Qendra për Kërkimet Ekonomike Evropiane (ZEW). U pyetën rreth 600 punëdhënësit të degës ekonomike të përkujdesjes shëndetësore dhe tre të katërtat e tyre e karakterizuan plotësimin e vendeve të lira të punës si të vështirë. Megjithatë, vetëm 16 përqind e sipërmarrjeve e kanë shfrytëzuar botën e jashtme për rekrutimin e punonjësve të huaj. Ato preferojnë që të tërheqin më mirë personel nga sipërmarrjet konkurente.

**Institucionet e vogla të përkujdesjes shëndetësore druhen ndaj të huajve**  
Kjo ka një shkak: shumë prej sipërmarrjeve të pyetura me përvojë rekrutimi të fuqisë punëtore në botën e jashtme e quajnë shumë të mundimshëm këtë opsion dhe shumë të shtrenjtë. Veç kësaj ekzistojnë edhe pengesa të mëdha juridike. 83 përqind të sipërmarrjeve kanë përvojë me njohjen nganjëherë të komplikuar të kualifikimeve dhe dëftesave. Edhe vështirësitë me leje e migrimit për shtete të treta ushtrojnë me sa duket efekt frikësues tek punëdhënësit gjermanë. Veçanërisht të vështirë e kanë sipërmarrje të vogla dhe të mesme. Studimi tregon: sa më e madhe të jetë sipërmarrja dhe sa më profesionist sektori i saj i burimeve njerëzore, aq më shumë punonjës të huaj arrin të fitojë.





FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



61 përqind e personelit përkujdesës shëndetësor (infirmierëve) vijnë nga Spanja. 19 përqind vijnë nga Polonia dhe 16 përqind nga Kroacia. Nga shtete jo anëtare të BE rrugën për në Gjermani e gjejnë para së gjithash fuqi punëtore nga Bosnjë-Hercegovina, Ukraina, Rusia, Kina dhe Filipinet. Pasi vijnë këtu, ato gjejnë kryesisht mbështetje si nga kolegët, ashtu edhe nga punëdhënësit. Para së gjithash lëvdohet angazhimi i tyre në punë. Gati gjysma e sipërmarrjeve të pyetura tha se angazhimi në punë i të huajve është madje më i lartë se i punonjësve gjermanë.

### **Migrantët e kualifikuar jo vetëm të lejohen, por të kërkohen**

Për të zbutur mungesat në personel në institucionet gjermane të përkujdesjes shëndetësore dhe në azile, botuesit e studimit kërkojnë informime më të mira të sipërmarrjeve, që duan të rekrutojnë punonjës jashtë vendit. Më tej kërkohet që në të gjithë Gjermaninë të praktikohen procedura të njësuara për njohjen e profesionit të personelit të përkujdesjes shëndetësore, si dhe rregulla më të thjeshta dhe më transparente për migrimin.

Një studim i ZEW i vitit të kaluar arriti në përfundimin se migrimi është pozitiv jo vetëm për ekonominë, por edhe për shtetin social gjerman. Kontributi i migrantëve për arkat e sigurimeve për pensionet, për institutet e sigurimit shëndetësor dhe sigurimin për të papunët mund të jetë më i lartë, sikur qasja e migrantëve në tregun gjerman të punës të ishte më e lehtë. Por kjo duhet të nxitet në mënyrë aktive politikisht, rekomandojnë autorët e studimit të ZEW./DW

**PORTALB**  
dritare realiteti

## **Maqedoni, cili është faktori kryesor për shtrëmbërime në shpinë te 25 mijë nxënës?!**



Të dhënat e fundit nga kontrollimi i rregullt mjekësor i nxënësve të Maqedonisë janë alarmante, pasi që sipas tyre 14 mijë fillorist dhe rreth 10 mijë nxënës të shkollave të mesme kanë shtrembërime në shpine. Jovanka Kostovska nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës thotë se institucionet janë të shqetësuara për këto të dhëna.

“Ministria e arsimit bashkë me atë të shëndetësisë janë marrë vesh që orët e edukatës fizike të jenë të obligueshme si deri tani, ndërsa arsimtarët të trajnohen që të japin



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



ushtrime për fëmijët me skoliozë.” Thotë Kostovska.

Mjeku Sedat Lumani thotë për Portalb se shumë shkaqe mund të ndikojnë deri te kjo gjendje e cila sipas tij është mjaft shqetësuese.

“Numri i nxënësve me këtë lloj deformimi është shumë i madh dhe krijon një situatë shqetësuese. Rezultat i shtrembërimit të shpinës mund të jetë jo aktiviteti fizik, qëndrimi shumë kohë para kompjuterit, do të thotë qëndrim jo i drejtë si dhe ndikim mund të ketë edhe çanta e rëndë të cilën ata e mbajnë çdo ditë për në shkollë”, tha për Portalb, Lumani.

Ai apeloj që prindërit të kenë kujdes dhe të mësojnë se si duhet të qëndrojnë fëmija dhe udhëzohen që të aktivizojnë ata në ndonjë sport apo diçka të tillë.

Prindërit nga ana tjetër fajësojnë profesorët dhe arsimtarët e edukatës fizike, ku sipas tyre nuk e bëjnë punën si duhet.

“Lexova për këtë rast dhe është skandaloze. Unë mendoj se përgjegjësinë për këtë e kanë mësimdhënësit e edukatës fizike të cilët marrin paga dhe nuk ushtrojnë fare me fëmijët. Dy tre ore në javë nuk janë pak për një fëmijë të ketë aktivitet fizik. Sipas mendimit tim e gjithë kjo bie në ndërgjegjen e tyre”, tha Suad Ferati, prind.

Disa prind të tjerë gjithashtu fajësojnë çantat e rënda që shkatërrojnë fëmijët e tyre.

“Më tregoni si mundet që në klasë të dytë të kenë nga 6 orë. Fëmija 6 vjeçar të rrijë 6 orë është e tepër, të ketë 6 lëndë. Mendoj se shtimi i lëndëve dhe rëndimi i çantës janë shkaqet kryesore që probleme me shpinën. Çdo ditë më duhet ta përcjell vajzën në shkollë, ja mbaj unë çantën, kjo situatë është e tmerrshme”, tha Sanije Jakupi, prinde.